



Republika e Kosovës
Republika Kosova Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së jugut
Opština Južna Mitrovica Municipality of Mitrovica South

FORMULAR PËR ANKAND PUBLIK

Titulli i Ankandit Publik	Ankand Publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër për 15 (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të Komunës me qëllim të ndërtimit të objektit garazhues (2B+P).
Referenca	Nr . 02-031-87031/2
Afati për dorëzimin e ofertave	Nga: 08/12/2016 Deri: 10/01/2017, ora 12:00.

Lokacioni	Parcela kadastrale: P-71208072-00616-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 1904 m ² , pronë shoqërore – Kuvendi Komunal Mitrovicë, (e cila gjendet tek vendi i quajtur “Mete Bajraktari”) në ZK – Mitrovicë.
-----------	--

Dorëzuesi i ofertës:

Operatori Ekonomik	N.T.P. "TRODIK"
Emri dhe Mbiemri	ISMAIL SHABANI
Data	10 01 /2017
E-mail dhe Telefoni	049/108222
Nënshkrimi	I. Shabani

Pranuesi i ofertës (zyrtari komunal):

Emri dhe Mbiemri	Belkisa Paolice
Data	10 01 /2017
Nr. Protokoli	02-111/01-00008/6/17
Nënshkrimi:	

OFERTA FINANCIARE PËR ANKANDIN PUBLIK

PËR : KUVENDIN KOMUNAL TË MITROVICËS

NGA: TROPIC N.T.SH – MITROVICË

OFERTA

Kompania Tropic me anë të kësaj letre për parcelën kadastrale P-71208072-00616-0 tek vendi I quajtur "Metë Bajraktari" me sipërfaqe prej 1904 m2 ofron çmimin 0,15 Euro për M2.

NTSH TROPIC

J. Habani

DATA: 10.01.2017





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opstina Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Nr. 02-031-87031/2

Datë: 07.12.2016

Në bazë të nenit 3, paragrafi 1.3 dhe nenit 8 pika (4) të Ligjit Nr. 04/L-144 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.35/ datë: 17 Dhjetor 2012), për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 2 paragrafi 4, pika (4.1), neni 4, 5 (par. 1), 6, 7 dhe 8, të Rregullores së Qeverisë së Kosovës Nr. 23/2013, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, e në zbatim të Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës Nr. 02/06-78330/6 dt. 27.10.2016, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës me qëllim të ndërtimit të objektit garazhuese, si dhe në zbatim të përgjegjësive sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 02/06-20378/5 dt. 31.03.2016, për themelimin e Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Komisioni Vlerësues, në mbledhjen e mbajtur më datën 07.12.2016, merr vendim për të rishpall:

A N K A N D

P U B L I K

Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër për 15 (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të Komunës me qëllim të ndërtimit të objektit garazhues (2B+P)

- I. IPET në shfrytëzim afatshkurtër, për 15 (pesëmbëdhjetë) vite, prona e paluajtshme (toka) komunale, si në vijim:**
 1. Parcela kadastrale: P-71208072-00616-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 1904m², pronë shoqërore–Kuvendi Komunal Mitrovicë, (e cila gjendet tek vendi i quajtur “Mete Bajraktari”) në ZK–Mitrovicë.
- II. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën I, është Ndërtimi i një Objekti Garazhues nëntokësor (2B+P) për ushtrim të veprimtarisë së biznesit, sipas Projektit ideor të bashkangjitur këtij Konkursi Publik.**
- III. Kriteret minimale për pjesëmarrje në Ankand Publik:**
 1. Operatori Ekonomik (OE) duhet të jetë shoqëri tregtare, i themeluar në bazë të ligjeve në fuqi në vendin e themelimit.
 2. OE nuk duhet të jetë i përfshirë në procedurë të falimentimit, likuidimit, administrimit ose të ngjashme.
 3. OE nuk duhet të jetë delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve në gjashtë muajt e fundit para datës së publikimit të Njoftimit për pjesëmarrje në Ankand Publik.
 4. OE duhet të ketë qarkullimi mesatar vjetor prej 500,000.00 EUR, për të paktën në 3 (tre) vitet e fundit (d.m.th. për çdo vit mesatarisht 500,000.00 EUR). Për grup te operatorëve ekonomik, mesatarja llogaritet si totali i grupit.
 5. OE duhet të ketë së paku 15 (pesëmbëdhjetë) punëtor të punësuar.



IV. Çmimi minimal i qerasë bruto mujore në Ankand Publik:

Çmimi minimal i qerasë bruto mujore që mund të ofrohet në ankand publik është **0,10 Euro/m²**.

V. Kriteri për dhënie të kontratës

Kontrata do t'i jepet Operatorit Ekonomik i cili i plotëson të gjitha kushtet minimale të kualifikimet të përcaktuara në pikën III të këtij njoftimi publik dhe që ofron çmimin më të lartë mbi çmimin minimal të përcaktuar në pikën IV të këtij njoftimi publik.

VI. Pjesëmarrja në Ankand Publik

1. Të drejtë pjesëmarrjeje dhe konkurrimi, kanë të gjithë personat fizik dhe juridik të Republikës së Kosovës (edhe personat jashtë Republikës, por që veprimtarinë e tyre e kanë të regjistruar në Republikën e Kosovës).
2. Personat fizik dhe juridik nuk ju lejohet që të marrin pjesë apo të konkurrojnë në të njëjtën kohë në mënyrë individuale dhe si anëtarë të një grupi apo si anëtarë të grupeve të ndryshme. *(Në raste të tilla operatori ekonomik dhe grupi i tillë do të jenë të papranueshëm).*

VII. Ankandi Publik do të jetë i hapur 33 ditë:

Nga – data **08.12.2016**, në ora **12:00** (dita e shpalljes në web-faqe të Komunës së Mitrovicës, tabelën e shpalljeve të Komunës, si dhe në gazetën ditore).

Deri më – datën **10.01.2017**, në ora **12:00**.

VIII. Hapja Publike e Ofertave bëhet në ditën e fundit të Ankandit Publik me datën 10.01.2017 në ora 12:00, në Sallën për Media në objektin e Komunës.

IX. Tërheqja e formularëve për pjesëmarrje dhe konkurrim mund të bëhet, në kopje fizike dhe elektronike çdo ditë pune, në Zyrën nr.10 apo në Qendrën për Shërbime me Qytetarë, çdo ditë pune nga ora 09:00 deri në orën 15:00.

X. Vëzhgimi i pronës së paluajtshme

Personat e interesuar, mund ta shohin pronën e paluajtshme të Komunës, çdo ditë pune nga ora **09:00** deri në orën **15:00** (me personel të autorizuar nga komuna).

XI. Dorëzimi i ofertës

Ofertat e kompletuara më se largu deri në datën 10.01.2017 në ora 12:00, duhet të dorëzohen fizikisht në Komunën e Mitrovicës së Jugut, rr. "Bedri Gjinaj" pa nr., në Zyrën nr. 10.

XII. Numri i kopjeve të ofertës

Ofertuesi përveç Ofertës origjinale, duhet të dorëzoj edhe dy kopje shtesë.

XIII. Tërheqja, zëvendësimi apo modifikimi i ofertës

Ofertuesit i lejohet që pas dorëzimit të ofertës të tërheq, të zëvendësoj apo modifikoj ofertën e tij jo më vonë se **tre (3) ditë** para hapjes së ofertave.

XIV. Informimi për Konkurs Publik mund të bëhet çdo ditë pune përmes:

web – faqe: <http://kk.rks-gov.net/mitrovica/>

mediave elektronike dhe të shkruara

numrit të telefonit: **+381 (028) 53 13 05**, dhe

e-mail adresës: **komuna.mitrovica@rks-gov.net**



Kryesuesi i Komisionit

E. Jashari

H.M. Egzon Jashari





OBJEKT GARAZHUES 2B


LOKACIONI: MITROVICË

INVESTITOR: KOMUNA MITROVICË

N.N.SH "VIZION PROJECT"

22.01.2015

PERSPEKTIVA



Vizion Project

Projekti, izvođenje, izrada, održavanje, održavanje

Ulica Matije Gupca 10, 10000 Zagreb, Hrvatska
T: +385 (0)1 4811 1111 F: +385 (0)1 4811 1112
E: info@vizionproject.hr

SIP. E BAZAVE


Sip. bruto BODRIMI (niveli -2.40) = 928.6 m²

Sip. bruto BODRIMI (niveli -4.80) = 928.6 m²


Total bruto = 1,857.2 m²

PRERJA A-A

PRERJA A-A




PERSPEKTIVA



Vizion Project

Proiecte de arhitectură, amenajare peisaj, amenajare spațiu verde
Strada 19, Nr. 141A, Sector 1, București
Tel: +40 21 209 00 00
E-mail: vizion@vizion.ro

PERSPEKTIVA



Vizion Project


Projeke, izvođenje, održavanje, servisiranje, održavanje
i održavanje objekata i objekata. Kontaktirajte nas na
broj 011 4100 0000 ili na e-mail adresu: info@vizionproject.com

BAZA E BODRUMIT (NIVELI -4.80)

Vizion Project
 Projekti, kontruktivni, termiku, unazg, GIE, hidrogjeometrija, inzhiniering, projektim dhe shperblime.
 Tiranë, Shqipëri
 Tel: +355 69 200 0000
 Email: vizion@vizionproject.com

BAZA E BODRUMIT

BODRUMI (NIVELI -4.80)
 DESTINIMI : PARKING
 SIP. = 928.6m²
 PARKING = 32 VENDE



BAZA E BODRUMIT (NIVELI -2.40)



Vizion Project

Projekti i këtij lloji të punës mund të kryhet vetëm nga Vizion Project

BAZA E BODRUMIT




BODRUMIT (NIVELI -2.40)

DESTINIMI : PARKING

SIP = 928.6m²

PARKING = 24 VENDE



NR. 1 VENDPARKINGJEVE


BODRIMI (niveli -2.40)= 24 vende

BODRIMI (niveli -4.80)= 32 vende

Total bruto = 56 vende

SITUACIONI

SITUACIONI




Vizion Project
The best design ideas, combining GIS, VR, BIM
and 3D rendering to create a better world.

2017

PLANI I BIZNESIT

PARKINGU I QYTETIT MITROVICA
PREZANTIMI I INVESTIMEVE

N.T.SH TROPIC
10.01.2017



PLANI I BIZNESIT
PARKINGU I QYTETIT MITROVICA

Mitrovicë , 2017

PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E PLANIT TË BIZNESIT	4
2. KUSH JEMI NE?	5
3. KU JEMI NE?	6
4. SWOT ANALIZA	6
5. EMRI I BIZNESIT	7
6. LOKACIONI.....	7
7. PERSONELI PUNUES	7
8. MISIONI	8
9. OBJEKTIVAT	8
10. ANALIZA E PRODUKTEVE DHE SHËRBIMEVE.....	9
11. PLANIFIKIMI I INVESTIMEVE.....	9
12. PËRSHKRIMI I PROCESIT TË PUNËS	10
13. SEGMENTIMI DHE TREGU ÇAK	10
14. POZICIONIMI NË TREG	10
15. STRATEGJIA E PËRKUFIZIMIT TË ÇMIMIT.....	11
16. PARASHIKIMI I SHITJEVE	11
17. IDENTIFIKIMI I INVESTIMEVE DHE SHPENZIMEVE	12
18. NEPAQJA I PËR KAPULAT DHE PLANI I FINANCIIMIT SHËRPSH	13
19. TABELAT FINANCIARE.....	14
20. TREGUESIT FINANCIARË.....	20

1. PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E PLANIT TË BIZNESIT

Biznes familjar me traditë 30 vjeçare i filluar në vitin 1987 nga ideja e z.Ismajl Shabani i cili filloi iniciativën e rregullimit të oboreve dhe riparime të nevojshme nëpër shtëpi dhe banesa. Ka fillu me një punëtor të vogël të improvizuar shtëpiake në qytetin e Mitrovicës dhe biznesin e emëroi TROPIC, dhe me ofrim të shërbimeve kualitative, korrektësi në punë dhe respektim të marrëveshjeve ndërmarrja ka arritur të rrit kapacitetet prodhuese, ndërtimin e një ndërmarrje stabile dhe ndërtimin e një tregu të mirë me partner të sigurtë dhe serioz. Arritja e rezultateve në tregun vendor ka qenë korrektësia, preciziteti, kualiteti i ofruar dhe ndershmëria në raport me klient. Ndërmarrja tani përveq anëtarëve të familjes, të cilët janë të inkuadruar ka edhe 20 punëtorë, të cilët punojnë me orarë të plotë në pozita të ndryshme .

Ndërmarrja ka asete të konsiderueshme për ofrimin e shërbimeve dhe produkteve (elementet e betonit) për terene nga më të ndryshmet.

Ndërmarrja ka objekt 2,300 m² (përfshirë edhe magacinonimi), parking diku rreth 1,000 m², 6 mjete transporti, si dhe një mori mjeteve që mundësojnë procesin e prodhimit dhe montimit elementeve të betonit.

Suksesi i planifikuar i ndërmarrjes sonë mund të shihet më së miri po ti hidhet një sy pasqyrave financiare. Nga këto pasqyra shohim se rezultati financiar i ndërmarrjes sonë për vitin e parë do të jetë 38,211.00 € neto fitimi, ndërsa në vitin e dytë parashikojmë të shesim në vlerë prej 167,606.40 € nga të cilat neto fitimi do të jetë 61,360.34€ , dhe në vitin e tretë do të shesim shërbime në vlerë prej 175,986.72 € kurse fitimi neto parashikohet që të jetë 68,902.62€.

Po ashtu kemi llogaritur edhe treguesit kyç financiarë me qëllim që të gjejmë përfitimin nga investimet dhe normën e kthimit të investimeve. Nga këta tregues del se në fund të vitit të parë për çdo 100 € investime realizon 27 € fitim, në fund të vitit dytë ndërmarrja jonë për çdo 100 € investime realizon 36 € fitim, kurse në fund të vitit të tretë kjo shumë tregon një ramje të lehta dhe atë për çdo 100 € investime kemi 39 € fitim. Kjo tregon se ndërmarrja jonë parashikohet të ketë një profit mjaft të mirë.

Gjithashtu, norma e kthimit të investimeve në vitin e parë është 6 %, norma e kthimit të investimeve në vitin e dytë është 10 % kurse në vitin e tretë 11 % .

Ndërmarrja është duke punuar dhe ky plan i biznesit është hartuar fillimisht për 3 vite, por kohëzgjatja e biznesit tonë mund të jetë deri në 10 vite me investimet që i kemi planifikuar në këtë plan të biznesit.



Pasqyrat Financiare – Pasqyrimi I te hyrave dhe profitit per 3 vite

2. KUSH JEMI NE?

Biznes familjar (me traditë 30 vjeçare i filluar në vitin 1987 nga ideja e z.Ismajl Shabani i cili filloi iniciativën e rregullimit të oboreve dhe riparime të nevojshme nëpër shtëpi dhe banesa. Ka fillu me një punëtori të vogël të improvizuar shtëpiake në qytetin e Mitrovicës dhe biznesin e emëroi TROPIC, dhe me ofrim të shërbimeve kualitative, korrektësi në punë dhe respektim të marrëveshjeve ndërmarrja ka arritur të rrit kapacitetet prodhuese, ndërtimin e një ndërmarrje stabile dhe ndërtimin e një tregu të mirë me partner të sigurtë dhe serioz.

- Ismajl Shabani – ka lind dhe është rritur në qytetin e Mitrovicës , ka të kryer skollën e mesme, është i martuar dhe dy fëmijë. Ismajli e njeh mirë tregun, posedon tipare të një lideri dhe udhëheqësi apo menaxheri të sukseshëm. Ai me të ardhur në shprehje të tipareve të tij me iniciativën personale, dëshirën për arritje të qëllimeve personale dhe guximin ka filluar me biznes privatë. Ka themeluar ndërmarrjen në rinin e tij në moshën 28 vjeçare dhe me ambiciet e tij dhe korrektësin ka arrit të përfitoj emër në treg. Vlen të përmendet se koha kur ka fillu me biznes privatë kanë qenë rrethanat shumë të vështira për arritje të suksesit, marketingut të panjohur, etj.

3. KU JEMI NE?

NTSH TROPIC merret me rregullimin e kopshteve dhe oboreve të shtëpive si dhe riparimet ndërtimore të shtëpive. NTSH TROPIC ofron një asortiment të gjerë të modeleve si klasike ashtu edhe moderne të elementeve të betonit , cilësia e produkteve e cila është unike dhe e dëshmuar.

NTSH TROPIC është kompani private e cila vepron në Republikën e Kosovës, përkatësishtë në qytetin e Mitrovicës.

Arritja e rezultateve në tregun vendor ka qenë korrektësia, preciziteti, kualiteti i ofruar dhe ndershmëria në raport me klient. Ndërmarrja tani përveq anëtarëve të familjes, të cilët janë të inkuadruar ka edhe 20 punëtorë, të cilët punojnë me orarë të plotë në pozita të ndryshme .

Ndërmarrja ka asete të konsiderueshme për ofrimin e shërbimeve dhe produkteve (elementet e betonit) për terene nga më të ndryshmet.

Ndërmarrja ka objekt 2,300 m² (përfshirë edhe magacinonimi), parking diku rreth 1,000 m², 6 mjete transporti, si dhe një mori mjetesh që mundësojnë procesin e prodhimit dhe montimit elementeve të betonit.

4. SWOT ANALIZA

4.1. PËRPARËSITË <S>

- Aftësitë dhe shkathhtësitë menaxheriale
- Motivimi i lartë i pronarit
- Marrëdhëniet dhe konsideraten ndaj klientëve
- Lokacioni mirë i përqendruar
- Partnerët strategjikë (marrëveshjet dhe kontratat)
- Kostoja e ulët e shpenzimeve
- Përvoja 30 vjeçare e arritur në këtë profesion
- Përkushtimi i pronarëve për zhvillim modern të kompanisë
- Stafi nuk ka nevoj për përgatitje profesionale

4.2. DOBËSITË <W>

- Marketingu jo i mjaftueshëm

- Shërbimet e kufizuara në disa shërbime të caktuara

4.3. MUNDËSITË (SHANSET) <O>

- Rritja e nivelit të kërkesës për shërbime
- Zhvillimi i industrisë së ndërtimit

4.4. KËRCËNIMET (RREZIQET) <T>

- Konkurrenca jo lojale (mundësia e uljes së çmimeve)
- Fatkeqësive natyrore

5. EMRI I BIZNESIT

Ndërmarrja jonë quhet dhe do të quhet edhe në objektin e ri: PARKINGU MITROVICA, parkingu do të jetë në kuadër të kompanisë TROPIC n.t.sh

6. LOKACIONI

Lokacioni (vendndodhja) e zhvillimit të biznesit tonë është një hapsirë në qendër të qytetit të Mitrovicës me kushte ideale për zhvillimin e veprimtarisë së parkingut të qytetit. Është lokacion ideal duke marrë parasysh se ky vend gjendet brenda vendbanimit, ka një pozitë shumë strategjike për zhvillimin e kësaj veprimtarie dhe dobinë të cilën qyteti i Mitrovicës ka nevojë për të. Lokacioni ka infrastrukturën komplete për të ndërtuar sipas standardeve të kërkuara për veprimtarinë e parkingut. Ndërtimi i objektit dhe pjesës përcjellëse do të ndërtohet me norma të larta të ndërtimit si në aspektin infrastrukturor, izolimit për të plotësuar kushtet e ruajtjes dhe qasjes normale dhe të sigurt të automjeteve në rrugë duke mos rrezikuar pjesëmarrësit në komunikacion.

7. PERSONELI PUNUES

Personeli i angazhuar përveq pronarit të firmës janë edhe njëzet punëtor. Me zgjerimin e kapaciteteve do të inkuadrohet kryesishtë personel i cili nuk duhet të jetë patjetër quadro profesionale. Numri i personelit i cilit është nevojshëm për ndërmarrjen konkretisht që të tregohet efektivitet dhe të jenë i nivelit të kërkuar është edhe 10 punëtorë shtesë. Për shumicën e vendeve nuk kërkohet ndonjë certifikim i posaqëm. Më poshtë në tabel do ti

PARKINGU I QYTETIT "MITROVICA"

shfaqim në formë tabelare strukturën e personelit të kërkuar duke precizuar profesionin, numrin dhe shpenzimet për pagat e tyre vjetore dhe ato janë:

Nr.	Pozita	Nr. i të punësuarve 2017	Paga				Gjithsejt (Euro)
			2017	2017	2018	2019	
1	Udhëheqës ndrimi	2	€ 400.00	€9,600.00	€9,600.00	9,600.00	28,800.00
6	Punëtorë parkingu	3	€300.00	€10,800.00	€10,800.00	10,800.00	32,400.00
7	Mirëmbajtës dhe logjistikë	2	€250.00	€6,000.00	€6,000.00	6,000.00	18,000.00
10	Roje	3	€220.00	€7,920.00	€7,920.00	7,920.00	23,760.00
	Gjithsejt	10	€3,187.00	€34,320.00	€34,320.00	34,320.00	102,960.00

Në kuadër të personelit punues të paraqitur në tabelë nuk është llogaritur angazhimi personal i pronarëve por vetëm angazhimi i punëtorëve të rinjë.

8. MISIONI

Misioni i ndërmarrjes sonë do të jetë:

Ofrimi i shërbimeve të parkingut për klientët duke ofruar siguri dhe mundësi për parking në qytetin e Mitrovicës,

9. OBJEKTIVAT

Objektivat të cilat ne synojmë janë të matshme dhe të arritshme dhe kjo do të ndodhë në mënyrë kronologjike duke iu referuar punës , kërkesave që kemi në rritje, parashikimeve, studimeve dhe rrethanave të përgjithshme.

Objektivat do ti paraqesim si më poshtë :

- Shtimin e shërbimeve deri në 20 % të kapacitetit për cdo vitë;
- Ofrimi i shërbimeve për 24 orë pune.
- Ndërtimi i një Plani Strategjik të Marketingut ;
- Për çdo vit do të shtojmë numrin e klientëve për 30% ;
- Shtimi i punëtorëve për cdo 3 vite
- Investime të reja në ndërmarrje cdo 3 vite për :
-Shtimin e produktivitetit ;

Objektivat e përmendura janë objektiva të cilat në aspektin kohorë janë më të shkurtra se 3 vite, dhe këto objektiva pas tre viteve do të ndërrojnë bazuar në zhvillimet e biznesit. Ato ndryshime do të përshtaten me tregun, konkurrencën dhe synimet e prodhimit të ndërmarrjes sonë.

10. ANALIZA E PRODUKTEVE DHE SHËRBIMEVE

Ndërmarrja TROPIC N.T.SH është e koncentruar në hapjen e parkingut të qytetit. Duke parë kërkesën, ofertën nga ana e komunës së Mitrovicës dhe hapsirën punuese pronaët kanë identifikuar një treg potencial për veprimtarin.

Shërbimet e ndërmarrjes janë :

1. Parkingu i qytetit :

Me këtë shërbim ne do të mundësojmë qytetarëve të Mitrovicës, qytetarëve tjerë të cilët nuk janë nga Mitrovica si dhe diaspora ti parkojnë automjetet e tyre.

- Mund të themi se shërbimet parkingut të qytetit janë mjaft të kërkuara dhe të domosdoshme për ditët e sosit në qytetin e Mitrovicës.
- Duke u bazuar në përparësitë tona siç janë angazhimi për shërbime kualitative si dhe kontrollimi i shpenzimeve jemi të bindur se ne si kompani do të jemi më konkurruese dhe kualitative në tregun cak.
- Kontrollimi i vazhdueshëm i kualitetit dhe zbatimi i parimeve etike dhe ndershmërisë besojmë se do kontribuojë në ruajtjen e emrit tonë të mirë.
- Parkingu do të shërbejë vetëm për automjetet të vogla dhe të mesme bazuar në hapsirën e kërkuar.
- Oferta do të jetë e pranueshme për tregun e Mitrovicës.

11. PLANIFIKIMI I INVESTIMEVE

Ndërmarrja planifikon investime të reja andaj Investimet e planifikuara do të hyjnë:

1. Ndërtimi i objektit dhe pjesët përcjellëse – do të bëhet ndërtimi i objektit me standarde të kërkuara për parking. Ndërtimi i pjesës gjelbëruese dhe këndit të lojërave për fëmijë për përshtatje ndaj infrastrukturës ekzistuese.
2. Pajisjet përcjellëse – sistemi komplet i pajisjeve përcjellëse në kuadër të shërbimeve dhe administratës.
3. Automjete – investimi në automjete të lehta

4. Tjera – investime të nevojshme për mbrojtje dhe rritje të natyrshme të ambientit
Këto investime planifikohet të kryhen brenda afatit 6 mujor.

12. PËRSHKRIMI I PROCESIT TË PUNËS

Shërbimet e parkingut kalonë në disa faza:

Faza e I

Hyrja e klientit me automjetin e tij, në fillim e mer biletën për hyrje ku fillon edhe numrimi i kohës së qëndrimit të automjetit

Faza e II

Dalja e automjetit ku dorëzohet kartela tek personi përgjegjës për pagesa dhe pas pagesës lejon daljen e klientit me automjet.

Të gjitha këto veprime do të shkojnë nën vëzhgimin e kamerave.

13. SEGMENTIMI DHE TREGU ÇAK

Tregu çak i shërbimeve tona është qyteti i Mitrovicës, ku planifikohet të bëhet ndërtimi i ndërtesës. Konkretisht shërbimet e kryera janë vetëm për automjete të lehta dhe të vogla ku vetëm në qytetin e Mitrovicës njihen të regjistruara rreth 5,000 automjete. Ky numër rritet në kohën e sezonës së vizitës së bashkëatdhetarëve tanë nga diaspora.

14. POZICIONIMI NË TREG

Ndërmarrja jonë ka një përvojë në treg dhe planifikojmë të marrim 5% të tregut total ku operojmë.

PROMOVIMI

Shitja dhe promovimi të shërbimeve tona do të bëhet në mënyrë sa më efektive duke përdorur të gjitha format e marketingut të cilat përcjellët nga ajo anë. Ne do të bëjmë një marketing përmes:

1. **UEB Faqën** – këtu do të prezantojmë produktet konkretisht shërbimet me foto ku do të kenë qasje një pjesë e madhe e njerëzve. Sipas statistikave të nxjerrura nga hulumtimi ynë del se cdo i 3-i person e përdor internetin dhe do ta jep gjasa të mëdha të reklamojmë objektin dhe prodhimet tona.

2. **Broshura/Paketimi** – broshurat janë si një formë e komunikimit apo reklamimit me klientët të cilët i vizitojnë por edhe do ti përhapim ato tek kompani nëpër qytete. Këto forma të promovimit do të kenë sukses duke u nis nga përvoja të cilën e kemi në të kaluarën.

15. STRATEGJIA E PËRKUFIZIMIT TË ÇMIMIT

Çmimi i llogaritur për momentin nuk pasqyron çmimin real sepse çmimi varet nga oferta dhe kërkesa në treg. Në bazë të kësaj strategjia e përcaktimit të çmimit të produkteve tona varet nga disa faktorë dhe ata janë:

- Çmimi i tregut,
- Shpenzimet,
- Synimi për profit.

Oferta aktuale për klientat është:

Nr	Shërbimi	Njësia	Sasia	Çmimi
1	Parking për automjete të vogla	Orë	3	€ 0.50
2	Parking për automjete të mesme	Orë	3	€ 1.00
3	Parking për automjete të vogla	Orë	Mbi 3	€/orë 0.50
4	Parking për automjete të mesme	Orë	Mbi 3	€/orë 1.00

16. PARASHIKIMI I SHITJEVE

Duke marrur parasysh kapacitetin dhe gjendjen aktuale të tregut të synuar atëherë parashikimi i shitjeve është si vijon:

Viti	Viti i OPERIMIT	Shitjet e projektuara
2017	Viti i parë	€ 139,672.00
2018	Viti i dytë	€ 167,606.40
2019	Viti i tretë	€ 175,986.72

PARKINGU I QYTETIT "MITROVICA"

Këto llogari janë bërë vetëm për tri vitet e para kurse në vitin e katërt dhe vitet tjera në vijim shitja e paraparë do të jetë më e lartë dhe atë në përputhje me rritjen e investimeve dhe ofrimit të shërbimeve dhe produkteve tjera shtesë.

17. IDENTIFIKIMI I INVESTIMEVE DHE SHPENZIMEVE

Ndërtimi i objektit me objektet përcjellëse do të jetë për 6 muaj. Ndonëse jemi një kompani që merret me shërbime dhe shitje të produkteve, investimet tona për realizimin e profiteve tona po i paraqesim në tabelën e mëposhtme:

Investimet	Njësia	Sasia	Çmimi mesatar (€)	Kostoja (€)
Objektet me hapsirat përcjellëse	M2	1900	293.15	556,985
Teknologjia komplete	Set	1	50,000	50,000
Inventar	Komplet	1	6000	6,000
Trajnimet e punëtorëve	Faturë	1	2,500	2,500
Totali i investimeve				615,485.00

Nevoja për investime shtesë apo investime përgjatë realizimit të projektit:

Investimet operative	Njësia	Sasia	Çmimi mesatar (€)	Kostoja (€)
Pagesa e e pagave	Muaj	6	19,122	19,122
Pagesat tjera	Fatura	1	2,500	2,500
Totali i investimeve				21,622

**18. NEVOJAT PËR KAPITAL DHE PLANI I FINANCIMIT
SHITESË**

<i>PLANI I INVESTIMEVE</i>	<i>PLANI I FINANCIMIT</i>
ASETET FIKSE	KAPITALI VETJAK
Objekti 556,985.00 (€)	Para të gatshme 634,607.00 (€)
Makinat & tjera 50,000.00 (€)	
ASETET E XHIROS	
INVESTIMET TJERA 27,622.00 (€)	
Investimet e përgjithshme 634,607.00 (€)	Financimi i përgjithshëm 634,607.00 (€)

Kapitali shtesë i nevojitur për realizimin e aktivitetit dhe arritjes së rezultateve të projektuara është i cekur në tabelën e lartëcekur.

19. TABELAT FINANCIARE

Më poshtë do të paraqesim tabelën e pasqyrës së të ardhurave dhe fitimet e parashikuara ndër vite.

TROPIC N.T.SH

Paqyra e të Ardhurave

Pershkrimi/Data	Aktuale	Të planifikuara	Të planifikuara
	1-Jan-17 31-Dhj-2017	1-Jan-18 31-Dhj-2018	1-Jan-19 31-Dhj-2019
Të hyrat			
Shitjet	€ 139,672.00	€ 167,606.40	€ 175,986.72
Kostoja e shitjeve	€ 0.00	€ 0.00	€ 0.00
Bruto margjina (a)	€ 139,672.00	€ 167,606.40	€ 175,986.72
Bruto margjina (përqindje e shitjeve)	100%	100%	100%
Shpenzimet			
Lista e pagave	€ 34,320.00	€ 34,320.00	€ 34,320.00
Kontributet	€ 1,716.00	€ 1,716.00	€ 1,716.00
Shërbimet publike	€ 3,000.00	€ 3,300.00	€ 3,300.00
Transporti/karburanti	€ 2,400.00	€ 2,640.00	€ 2,640.00
Telefon/Faks	€ 1,250.00	€ 1,375.00	€ 1,375.00
Riparimet dhe Mirëmbajtja	€ 6,960.00	€ 7,656.00	€ 7,656.00
Ushqimi	€ 1,320.00	€ 1,452.00	€ 1,452.00
Të ndryshme	€ 6,000.00	€ 6,600.00	€ 6,600.00
Reklamat dhe Marketingu	€ 1,200.00	€ 1,320.00	€ 1,320.00
Shpenzimet e paparashikuara	€ 0.00	€ 0.00	€ 0.00
Kostojt e Amortizimi	€ 39,049.25	€ 39,049.25	€ 39,049.25
Kamata	€ -		€ -
Shpenzimet totale (b)	€ 97,215.25	€ 99,428.25	€ 99,428.25
Profiti para tatimeve (c=a-b)	€ 42,456.75	€ 68,178.15	€ 76,558.47
PROFITI/HUMBJA NETO (pas Tatimit 10%)	€ 4,245.68	€ 6,817.82	€ 7,655.85
PROFITI/HUMBJA NETO	€ 38,211.08	€ 61,360.34	€ 68,902.62

PASQYRA E TË ARDHURAVE




Pasqyra e te ardhurave te parashikuara per 3 vite

Fig.9

Pasqyra e të ardhurave

Në tabelë do të shihet një rritje e të hyrave për cdo vitë si rritje e tregut dhe shitjes.



Pasqyra e te ardhurave te parashikuara per 3 vite

Fig.9

Pasqyra e të ardhurave

Në tabelë do të shihet një rritje e të hyrave për cdo vitë si rritje e tregut dhe shitjes.

PARKINGU I QYTETIT "MITROVICA"

CASH FLOW

Më poshtë e paraqesim Cash Flow të parashikuar të ndërmarrjes:

TROPIC N.T.SH CASH FLOW			
Të gatshme	2017	2018	2019
Shitjet me para të gatshme	€ 139,672.00	€ 167,606.40	€ 175,986.72
Investime te reja	€ 0.00	€ -	€ -
Paraja ne fillim	€ 615,485.00	€ 77,260.33	€ 177,669.91
Gjithsej para të gatshme (a)	€ 755,157.00	€ 244,866.73	€ 353,656.63
Furnizimi /lënda e parë	€ 0.00	€ 0.00	€ 0.00
Lista e pagave	€ 34,320.00	€ 34,320.00	€ 34,320.00
Kontributet	€ 1,716.00	€ 1,716.00	€ 1,716.00
Shërbimet publike	€ 3,000.00	€ 3,300.00	€ 3,300.00
Transporti	€ 2,400.00	€ 2,640.00	€ 2,640.00
Telefon/Faks	€ 1,250.00	€ 1,375.00	€ 1,375.00
Riparimet & Mirëmbajtja	€ 6,960.00	€ 7,656.00	€ 7,656.00
Ushqimi	€ 1,320.00	€ 1,452.00	€ 1,452.00
Të ndryshme	€ 6,000.00	€ 6,600.00	€ 6,600.00
Reklamat & Marketingu	€ 1,200.00	€ 1,320.00	€ 1,320.00
Shpenzimet e paparashikuara	€ 0.00	€ 0.00	€ 0.00
Kamata	€ 0.00	€ 0.00	€ 0.00
Investimet/Pajisjet/tjera	€ 615,485.00	€ 0.00	€ 0.00
Tatimet/licencat	€ 4,245.68	€ 6,817.82	€ 7,655.85
Shpenzimet totale (b)	€ 677,896.68	€ 67,196.82	€ 68,034.85
Cash ne fund	€ 77,260.33	€ 177,669.91	€ 285,621.78

CASH FLOW




Fig.10

Cash Flow e Parashikuar për 3 vitet e ardhshme

Pasqyra e Cash-it e tregon një tregëtim shumë likuid të ndërmarrjes dhe posedimit të mjaftueshëm të keshit. Planifikimi strategjik i ndërmarrjes për mbledhjen e keshit do të jetë shumë efikas duke bërë përmbylljet mujore të gjithë borxheve të cilat ia kanë ndërmarrjes. Borxhet nuk do të lejohen mbi mesataren e përballjes së vetë ndërmarrjes dhe mundësin e saj për pagesë.

PARKINGU I QYTETIT "MITROVICA"

BILANCI I GJENDJES

TROPIC N.T.SH			
Bilanci			
	Të planifikuara 31/12/2017	Të planifikuara 31/12/2018	Të planifikuara 31/12/2019
Asetet			
Asetet rrjedhëse			
Të gatshme	€ 77,260.33	€ 177,669.91	€ 285,621.78
Arketimet	€ 13,500.00	€ 16,580.00	€ 16,580.00
Stoku	€ 0.00	€ 38,000.00	€ 38,000.00
Total Asetet Rrjedhese	€ 90,760.33	€ 232,249.91	€ 340,201.78
Asetet afatgjata			
Ndërtesa	€ 556,985.00	€ 556,985.00	€ 556,985.00
Pajisjet kapitale	€ 0.00	€ 0.00	€ 0.00
Inventar & Tjera	€ 56,000.00	€ 56,000.00	€ 56,000.00
Amortizimi i akumuluar	-€ 39,049.25	-€ 78,098.50	-€ 117,147.75
Total asetet afatgjata (b)	€ 573,935.75	€ 534,886.50	€ 495,837.25
Total asetet (c=a+b)	664,696.08	767,136.41	836,039.03
Detyrimet			
Detyrimet Afatgjata			
DETYRIMET (d)	0.00	0.00	0.00
Kapitali			
Kapitali I Pronareve	€ 626,485.00	€ 705,776.08	€ 767,136.41
Fitimi I bartur nga viti I kaluar	€ 38,211.08	€ 61,360.34	€ 68,902.62
Total kapitali + detyrimet (K=d+f)	€ 664,696.08	€ 767,136.41	€ 836,039.03




Fig.11

Bilanci i gjendjes i parashikuar për 3 vite

Bilanci i gjendjes ka një rritje ndërvite, kjo tregon një rezultat pozitivë në rritjen e biznesin dhe suksesin e saj.

20. TREGUESIT FINANCIARË

Duke u bazuar në pasqyrat financiare kemi bërë edhe nxjerrjen e disa treguesve financiarë për ndërmarrjen tonë, të cilët janë:

1. PROFITABILITETI

1.1 Margjina (Norma e profitit neto) = (Profiti neto / Të ardhurat bruto)*100

Për vitin e parë: Margjina = $38,211.00 / 139,672.00 = 0.27 * 100 = 27\%$

Për vitin e dytë: Margjina = $61,360.34 / 167,606.40 = 0.36 * 100 = 36\%$

Për vitin e tretë: Margjina = $68,902.62 / 175,986.72 = 0.39 * 100 = 39\%$

Nga më lartë shohim se fitimi nga viti në vitë rritet dhe atë në vitin e parë ndërmarrja realizon fitim 27€ dhe rritet në 39€ nga 100€ kjo tregon një përfitim konstantë me të cilin ndërmarrja ka një orientim në fitim në bazë të sasisë së shitjes. Kjo tregon se ndërmarrja jonë ka një profit neto mjaftë të mirë.

1.2 Norma e kthimit të investimeve = (Profiti neto / Asetet totale)*100

Për vitin e parë: Margjina = $38,211.00 / 612,985.00 = 0.06 * 100 = 6\%$

Për vitin e dytë: Margjina = $61,360.34 / 612,985.00 = 0.10 * 100 = 10\%$

Për vitin e tretë: Margjina = $68,902.62 / 612,985.00 = 0.11 * 100 = 11\%$

Nga më lartë shohim se norma e kthimit të investimeve në vitin e parë është 6 % dhe për çdo vitë tjetër ajo vazhdon dhe rritet. Kjo tregon një biznes stabil dhe kthim të investimeve për kohë shumë të shkurtër prej 3 vitesh. Investimi në këtë biznes është më se profitabil duke u bazuar në faktet aktuale.





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije-
Ministry of Trade and Industry

Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë / Kosovska Agencija za Registracije Biznisa /
Kosova Business Registration Agency

CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
CERTIFICATE OF REGISTRATION

80091087

(Nr. i biznesit / Br. biznisa / Business No.)

N.T.P."TROIPIK"

Emri i biznesit / Naziv biznisa / Name of Business

Lloji i biznesit
BusinessType
Tip biznesa

Biznes individual
Personal Business Enterprise
Privatno produzeće

Adresa
Address
Adresa

Republika e Kosovës, Mitrovicë, Shipol
Republic of Kosovo, Kosovska Mitrovica, Šipolje
Republika Kosova, Kosovska Mitrovica, Šipolje
, D.Kombit

Data e Inkorporimit
Date of Incorporation
Datum Inkorporiranjë

29/08/2006

Data e regjistrimit
Date of registration
Datum registracije

20/06/2000

26/10/2009

Data/Date/Datum


Nenshkrimi/Signature/Potpis





Informata mbi biznesin
Information about business
Informacija o biznisu

Nr. Biznesit/Business No./Br. Biznisa
80091087

Aplikacioni/Application/Aplikacija

Subjekti i regjistrimit:
Registration subject
Subjekt registracije:

Data e plotësimit:

Filling date: 20/06/2000

Datum:

Date e pranimit:

Reception date:

Datum prmljenje

Numri i protokolit:

Protocol number: 111000124

Broj protokola:

Biznesi/Business/Biznis

Tipi i biznesit: Biznes individual
Business type: Personal Business Enterprise
Tipi biznisa: Privatno produzece

Emri i biznesit:
Business name: N.T.P."TROPIK"
Naziv biznisa:

Adresa: Republika e Kosovës, Mitrovicë, Shipol
Address: Republic of Kosovo, Kosovska Mitrovica, Šipolje
Adresa: Republika Kosova, Kosovska Mitrovica, Šipolje
, D.Kombit

Data e konstituimit:
Constitution date: 29/08/2006
Datum konstituisanja:

Kapitali i përgjithshëm:
Total Capital:
Totalni kapital:

Numri i puntorëve:
Number of employees: 3
Broj radnika:



80091087

Personat e autorizuar / Authorized participants / Ovlascene lice

Emri: Ismail
Name: Shabani
Ime:

ID Personale:
Personal ID: 1005140095
Licni ID:

Pozita e punës:
Job position: Agj. i regjistruar
Radno mesto:

Adresa: Republika e Kosovës, Mitrovicë, Shipol
Address: Republic of Kosovo, Kosovska Mitrovica, Sipolje
Adresa: Republika Kosova, Kosovska Mitrovica, Sipolje
D. Kombit



80091087

Pronarët/Owners/Vlasnici

Person fizik

Emri: Ismail
Name: Ismail
Ime: Shabani

ID Personale:
Personal ID: 1005140095
Licni ID:

Adresa: Republika e Kosovës, Mitrovicë, Shipol
Address: Republic of Kosovo, Kosovska Mitrovica, Šipolje
Adresa: Republika Kosova, Kosovska Mitrovica, Šipolje
D. e Kombit

Përgjegjësia:
Liability:
Odgovornost: Përgjegjësi e pakufizuar

Pjesa në pronë:
Owned part:
Deo o vlasnistvu:

Pjesa e paguar:
Paid Part:
Placeni deo:



80091087

Veprimtaritë/Activities/Delatnosti

Other Construction of water projects
Other Izgradnja hidrogradjevinskih objekata

4525

Punimet e tjera te specializuara të ndërtimit
Other Other construction work involving special trades
Other Ostali gradjevinski radovi, ukljuejuai i specijalizovane radove

4531

Vendosja e instalimeve elektrike
Other Installation of electrical wiring and fittings
Other Postavljanje električnih instalacija i opreme

4533

Vendosja e instalimit për ujë, gaz, ngrohje, ventilacion dhe për ftohje
Other Plumbing
Other Postavljanje cevni instalacija

4534

Punime të tjera të instalimeve
Other Other building installation
Other Ostali instalacioni radovi



80091087

Veprimtaritë/Activities/Delatnosti

4521

Primar Ndërtimi i lartë dhe ndërtimi i ulët
Primary General construction of buildings and civil engineering works
Primar Grubi gradjeviski radovi i specifični radovi niskogradnje

2651

Other Prodhimi i cimentos
Other Manufacture of cement
Other Proizvodnja cementa

2661

Other Prodhimi i produkteve me beton për ndërtim
Other Manufacture of concrete products for construction purposes
Other Proizvodnja proizvoda od betona, cementa i gipsa

2663

Other Prodhimi i betonit të gatshëm për ndërtim
Other Manufacture of ready-mixed concrete
Other Proizvodnja gotove betonske smeše

2666

Other Prodhimi i produkteve të tjera me beton, cemento dhe allci
Other Manufacture of other articles of concrete, plaster and cement
Other Proizvodnja ostalih proizvoda od betona, cementa i gipsa

4545

Other Kompletimet tjera ndërtimore
Other Other building completion
Other Ostali završni radovi

6024

Other Transporti rrugor i mallrave
Other Freight transport by road
Other Prevoz robe u drumskom saobraaaju

5132

Other Tregtia me shumicë e mishit dhe produkteve të mishit
Other Wholesale of meat and meat products
Other Trgovina na veliko mesom i proizvodima od mesa

4522

Other Ngritja dhe mbulimi i konstruksioneve të kulmeve
Other Erection of roof covering and frames
Other Montaža krovnih konstrukcija i pokrivanje krovova

4523

Other Ndërtimi i autostradave, rrugëve, aeroporteve dhe objekteve sportive
Other Construction of highways, roads, airfields and sport facilities
Other Izgradnja saobraaajnica, aerodromskih pista i sportskih terena

4512

Other Gërmimet dhe sondazhet
Other Test drilling and boring
Other Ispitivanje terena bušenjem i sondiranjem

4524

Punimet bregdetare dhe lumore (portet, diga etj.)



VËRTETIM TATIMOR TAX VERIFICATION PORESKA POTVRDA

Administrata Tatimore e Kosovës verifikon se personi i identifikuar më poshtë:

Tax Administration of Kosovo certifies that the person identified below:

